



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme
Zyra e Prokurimit



Shkresë	29.07.2020
Nga:	Zyra e Prokurimit Z.P.P BLERIM NIKA
Te:	Per Operatorët ekonomik
Lënda:	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik, Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht Neni 108/A pika 10.1 dhe Rregullave për parashtrimin e kërkesës për Ri-shqyrtim të Njoftimit për Kontratë, Zyra e Prokurimit, **nxjerrë:**

Vendim

1. Aprovohet si e pa bazuar kërkesa e dt, 27/07/2020, për Ri-shqyrtim të Njoftimit për Dhenjë për projektin me titull “SIGURIMI FIZIK I TRI OBJEKTEVE – GJIMNAZIT “SKENDERBEU”, SHMP TE TEKNIKES “FEHMI LLADROVCI” DHE OBJEKTIT TE KOMUNES –RITENDERIM “ me nr. prokurimit 611-20-001-211 dhe me nr të jashtem të prokurimit 611-20-2536-211 Lidhur me kërkesat e pershtetshmëris profesionale dhe teknike.

Arsyetim

Një operatorë ekonomik ka paraqitur kërkesë për Ri-shqyrtim lidhur me Njoftimin për Dhenje për Tenderin ” “SIGURIMI FIZIK I TRI OBJEKTEVE – GJIMNAZIT “SKENDERBEU”, SHMP TE TEKNIKES “FEHMI LLADROVCI” DHE OBJEKTIT TE KOMUNES –RITENDERIM ” lidhur me kërkesat e përshtatëshmëris profesinale dhe teknik sipas neni 69 pika 4. Dhe 4.1, 4.2 të LPP.

AK ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga OE dhe ka konstatuar se kërkesa është e **pabazuar** . Autoriteti Kontraktues Komuna e Drenasit asnjehere nuk e ka cekë se OE që do të marrin pjesë në këtë Procedure të prokurimit do jenë 12 punonjës (Ne nuk kemi cekë në asnjë sqarim se sa punonjes do te angazhoje OE ne kete aktivitet te prokurimit , interes I AK eshte qe sherbimi te kryhet konform kerkesave te AK) , andaj çdo kalkulim i berë nga ana e OE

pjesmarrës për numrin e puntorëve që do të përfshihen në këtë projekt nuk ka qenë kriter i AK .
Ak Komuna e Drenasit ka bërë llogaritjen e çmimeve për tenderët jo-normalisht të ulta dhe të gjitha ofertat ishin të përgjegjshme (asnjë ofertë nuk ishte nën pragun për çmime jo normalisht të ulta 71,302.9) .

Pala e paknaqur ndaj vendimit të AK mund të paraqet ankesë në OSHP në afatë prej 10 ditë

.

Me respekt